

ARBEN SHEHI
JETA, KJO MREKULLI PA VLERË
POEZI

BOTIMET TOENA

ARBEN SHEHI

*Jeta,
kjo mrekulli pa vlerë*

poezi

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2014

Botuese: Irena Toçi

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: A. Shehi - “Parku në vjeshtë” (vaj)

ISBN 978-99943-1- 954-1

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Ditikës

Tani i shoh të gjitha ëndrrat me ngjyra.

*Rrëzohen qiej të përflakur malli në duart e mia,
si frutat e pjekura nga degët e pemëve që i mbledh era.
Dhe mrekullia që s'di të pushojë,
për sa kohë asgjë s'ka më vlerë
se sa e gjithë kjo jetë magjike vdekatari
e jetuar me ty.*

parafjalë...

E PËRJETSHME

Bota rëndon e ikën shpejt.
Rrotullimi i saj nën peshën njerëzore
nuk gjen kurrë prehje.

Dikush vë një sup,
dikush një krah...

Shpirtin e tyre e vënë vetëm Poetët.

*Faqja e mbështetur në faqen e moshës,
dora mbi dorën tjetër që rrudhet pa e ndier.*

*Pema që gjethon ende,
sythet e lagura nga mjegullat e dritës,
atëherë kur pranverën s'e ndal më asgjë.*

JETA,

SHKODRA E MBRETËRVE

*... hapësirës së fëminisë sime
dhe të bashkëmoshatarëve...*

U ktheva në vendlindje,
në vendin ku zënë fill tërë ujërat e botës.

Malli rend para meje si një shpirt pa qetësi.
Kërkon pragun e moshës pa kthim, të gjitha stinët e erës,
qiellin e bërë lutje për kohën që e pata lënë aty.

Tërë ujërat e botës i kam ditur se burojnë nga ky qytet.
Tërë mbretëritë e botës, tërë kështjellat e rrëzuara nga dhimbja,
para së gjithash nga gjiri i murosur i një Gruaje, nënë lehonë
e tradhtuar nga të vetët.

Tërë ujërat e botës i kam ditur se burojnë nga ky qytet.
Tërë liqenet që ruajnë brenda shpirtin e shirave,
tërë zogjtë shtegtarë që s'gjejnë prehje,
tërë largësitë e botës bërë kurorë për çdo gur,
për çdo zog shtegtar.

Tërë ujërat e botës i kam ditur se burojnë nga ky qytet.
Tërë shirat që kanë rënë nga shpirti i reve. Po ti që u thinje
nga dimrat e dhimbjes duke më pritur mua,
u bëre patjetër statujë e përjetshme, cak ndjellamirës,
altar i shenjtë ku ditët bien në gjunjët e shpresës.

U ktheva në Shkodrën e mbretërve,
në vendin ku zënë fill tërë ujërat e botës.

2012

NJË LULE VJOLLCË

U rrëzuan edhe fletët e fundme
nga degët tërë vjeshtë të muzgut.
Xhamat e vjeshtës po krisin një e nga një,
dhe era si një plakë e verbër që shkel mbi kalldrëmin e reve
troket me shkopin magjik mbi yjet e Kashtës së Kumtrit.

Ti nuk je më. As hëna që e le të ndezur si një përshpirtje
mbi supet e natës së fundit.

Si ia bën vallë pa mua netëve pa hënë,
në fushën e dorëzuar kaq lehtë dhe kaq trishtueshëm
perandorisë së bardhë të dëborës?

Si ia bën vallë kur bien gjethet?
Gjethet janë fryma e vjeshtës,
shpirti i qiellit pa gojë të pikëlluar nga largësia e pranverës.
Po ti, si ia bën vallë nën shkretimin e paanë të qiellit,
në këtë memecllëk ngjethës të verbërisë së dimrit?

Prapëseprapë,
unë do te vij ashtu, gjysmë i gjallë,
të vë një lule vjollcë te guri i heshtjes tënde fatale...

O Zot, sa e shkurtër ishte kjo vjeshtë!

Gusht 2010

ZEMRA E KUJTESËS

Më mirë ik dhe mos e kthe kokën prapa!
Nuk do të ketë ylber',
sepse nuk ranë shirat që i pritëm
nën kabanën e shurdhët të qiellit.

Ndoshta sepse nuk mbeti, qoftë edhe aq pak qiell për ty,
dhe për mua.
Ose sepse pjesën tënde të qiellit
ti e vendose si kurorë thurur me degë ylberi
te kryet e përgjumur të mëngjesit.

Amin, dashuria ime!
Do të jetoj me kujtimin tënd,
qoftë edhe disa çaste të vetme.
Sepse nuk mund të vdes pa dëgjuar qoftë edhe një herë të
fundit
rrahjen e zemrës tënde mbi zemrën time,
nën dheun e harresës që dikush na e ka bërë gati si blasfemi
të na e hedhë mbi varrin e përbashkët dhe të pagojë.

Po tani po them: “Më mirë mos ik vetëm,
jetojmë edhe pak.
Pastaj le të vendosë vetëm zemra e kujtesës
për fatin tonë prej drite”.

2012

AROMË DASHURIE

Vallë, ku ke qenë ti kur unë zgjodha Arushën e Madhe
si taksi nusërie për dasmën e mëngjesit?
Ku ke qenë kur zgjohej dita përmbi zallin e lumit
dhe mbushte shtambën e yjeve
në burimin e kulluar të gjinjve të tu?

Ndofta nuk do të ketë më aromë dashurie,
sepse vjeshta nuk mund të vijë dot pa shira.
Shirat nuk do të kenë arsye të bien mbi tokën e etur
dhe të avullojnë pa fund për t'u kthyer sërish po aty.

Sepse, me sa duket, do të na mungojë frymëmarrja.
Ose dashuria do të presë vjeshtën që të shkundë
edhe gjethen e fundit të zverdhur dhe pa jetë,
që të mbesë pastaj e vetme dhe e përjetshme
nën lakuriqësinë pa shpirt të dimrit.

Po atëherë, përse mungoje ti kur dimri jepte shpirt
nga afrimi i pranverës dhe aroma dehëse e gjinjve të tu?

Sepse edhe Arusha e Madhe kurrë s'i bën ballë
epimit prej dashurisë,
gjithherë që dimri lëngon i lodhur dhe i pashpresë,
në zgrip të dritës që kullon blu nga hapësira...

2010

PËRMENDORJA E DHIMBJES

Zgjohu, Poet! Erdhi ora për të vdekur përsëri.

Vish këmishën e dritës, petkat e diellit,
zbukuruar me lëngështimin e pranverës.
Të thërret mosha e burrit, lindja e erës nga hareja e drurëve,
zhurmërimi i heshtjes së përjetshme të bletëve,
krenaria e tyre, sepse askush s'ka mundur deri më tash
t'jua marrë lirinë para vdekjes.

Zgjohu, Poet! Erdhi koha për të vdekur përsëri.
Ngrihu dhe bëhu i bukur, si dhëndërimi qiejve në vjeshtë.
Në asnjë stinë tjetër nuk mbetet pa frymë mosha e fjalës.
Lirinë e saj ne kurrë s'e ndamë nga gjaku. Tani është ora
të vdesësh dhe të lindësh bashkë me të.
Ia vlen, mbi të gjitha, një jetë me trimëri.

Zgjoju, Poet! Erdhi koha për të kënduar himnin e dritës.
Jeta është një konvencion krejt i mangët
pa luftën dhe humbjen, dhe pa fitoren ngadhënjyese
përsëri.

Eja të ngremë përmendoren e dhimbjes, kurorat e heshtjes
thurur me emrat tanë. Kush dhimbjen nuk e provoi në jetë,
nuk mundet kurrë të vdesë për një varg
dhe të bëhet dritë qoftë edhe për një fjalë.

Zgjoju, Poet! Erdhi ora për të lindur përsëri.

2010

NJË VIT VETMI

Në përvjetorin e parë të ikjes së nënës.

Të kërkoj në dhomë e s'të gjej.
Tringëllijnë shirat e pasdites te dritaret
si ajri i mbushur dikur përplot me praninë tënde...
Ku ke qenë ti gjithë këto net,
kur unë dilja i vetëm nën hënën e përgjysmuar
nga avullimi i lotëve?
Nën ç'yllësi shtegtoje vallë?

Të kërkoj dhe s'të gjej më askund.
Ç'të bëj me zogjtë te dritarja,
me cicërimat e tyre që presin thërrimet
vetëm prej dorës tënde?
Më thuaj, ç'të bëj me ajrin e mbrëmjes
që dridhet si përsphirtje pa shpirt në duart e mia?

Zemra ime bërë gurë vetmie.
Ti mos i beso gjithmonë të vërtetës!

Prill 2010

DAL NË RRUGË

Dal në rrugën e shkretë
ku fryn era e dimrit.

Pranvera dhe vjeshta kanë qenë këtu para meje
dhe hapat e tyre janë kudo.
Si prekje mbi drurët që vajtojnë lakuriq nën shi,
humbjen sezonale të virgjërisë.

Po para të gjithave,
përpara vjeshtës dhe dimrit, para pranverës vetë,
këtu ke qenë ti:

me një lule vjollce në dorë
duke kërkuar varrin e shiut për homazh.
Hap pas hapi në ndjekje të erës,
sa herë që dashuria jote ma urdhëron
dorëzimin tim pa kushte.

Dal në rrugën me dimër
ku fryn era e shkretë...

DËBORA

Ah, unë kurrë s'kisha dyshuar në pastërtinë e bardhë
të dëborës.
Në tronditjen e ndershme të dimrit
sa herë i duhet t'i përulet shfaqjes ngadhënjyese të pranverës.

Por erdhe ti, u duk hiri yt,
bashkë me fundin e vajzërimit tënd,
si një peng besnikërie në duart e mia
mbushur me padurim marsi.

Përse i druhesh arratisë së akujve,
shkrirjes së ujërave, gjethimit të lisit plak?

Do të kthehem për ty. Të të rithem se të dua
njëlloj si para një mijë vjetëve,
ose mbase më shumë se të desha një ditë më parë,
më shumë se në natën e fundit të ditës së fundit.
Si në atë mëngjesin e tronditur mrekullisht
nga aroma e vajzërisë tënde mbetur e paprekur në buzët e mia.

Dëbora s'kish dyshuar kurrë
në bardhësinë e dashurisë sime.

2011

PIKË-PIKË

Bie shiu pikë-pikë nga streha e rrënuar e çatisë së vjetër.
I bukur si nëpër ëndrra,
dhe mua më kujtohesh ti.
E vogël dhe e brishtë si një zanë e trembur
prej frikës se fuqia kreshnike e Mujit
po tretej dalëngadalë nga fama e Halilit të Ri.

Po dhimbja nuk qenka thjesht te mungesa jote,
as te heshtja përtej çdo pike shiu
që përmallet pas qelqeve si adoleshent.

Shpesh frika është shumë më e madhe se sa vetë zemra.
Një qiell që s'do t'ia dijë për shkrepjet,
sa herë që e përshkojnë vetëtimat e mallit
për atë çka nuk e bëmë dot.
Më kujtohet aroma e gjinjve të tu që dridheshin
si pendët e një mjellme të plagosur mbi duart e mia,
ngaqë nuk mundte të jepte shpirt e vetme dhe e virgjër.

Bien ëndrrat njëra pas tjetrës,
të bukura dhe përrallore
si pikat e këtij shiu të përlotur...

Tetor 2012

URAT E BOTËS

Rrëzohen trembshëm ditët e qershorit përmbi këtë Urë,
nën hënën që rri zgjuar dhe ruan gjumin e yjeve,
e trembur se mund të mbyten në ujërat e pranverës
që shkrijnë e shkrijnë pa fund.

Më kujtohet hera e fundit me ty.
Asgjë nuk ka ndodhur,
është vetëm ajo, dashuria pra,
që i ka bërë “një hiç” largësitë dhe hapësirën.
Këtë Urë të ribërë njëlloj si më parë,
çuditërisht me formën e mrekullueshme të trupit tënd
dhe të tërë grave të botës
harkuar kaq femërisht mijëra herë para meje.

Por prapëseprapë, ti s'bën dot pa rëndesën time
shpërndarë mbi të gjithë hapësirën tënde klandestine,
edhe pse nuk e di se ku po shkoj, çfarë dua,
kush më pret atje...?!

Sepse të gjitha urat e botës i ngjajnë kurmit çudibërës
të çdo gruaje, të çdo femre
kur i pushton të dy brigjet.
I afron, i mbush dhe i lag me pështjellimin foshnjarak
të ngrohtësisë femërore.

Sepse, prapëseprapë,
unë s'bëj dot pa rëndesën tënde të magjishme...

Ura e Mostarit, qershor 2012